

VENDIM
Nr. 55, datë 24.2.2023

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s
LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË KESH SHA PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA TEC-i I
LUNDRUESHËM I INSTALUAR NË PORTIN E TRIPORTIT NË GJIRIN E VLORËS

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 305/5 prot., datë 23.2.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-i i lundrueshëm i instaluar në portin e Triportit në gjirin e Vlorës”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 350, datë 28.12.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë KESH sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-i i lundrueshëm i instaluar në Portin e Triportit në Gjirin e Vlorës, me fuqi të instaluar 110 mw.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 30.12.2022 dhe 31.12.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 28.1.2023) nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresat nr. 2074/3 prot., datë 30.12.2022, dhe nr. 308/2 prot., datë 7.1.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht. KESH sh.a. me shkresën nr. 37/4 prot., datë 31.1.2023, protokolluar në ERE nr. 308/1 prot., datë 1.2.2023, ka depozituar pjesërisht dokumentacionin e kërkuar për këtë aplikim.

- ERE, me shkresën nr. 308/3 prot., datë 10.2.2023, i është drejtuar me kërkesë për informacion edhe OST sh.a., në lidhje me statusin e nënshkrimit të marrëveshjes së pikës së lidhjes së TEC-it me rrjetin e transmetimit, për të cilën nuk kemi ende një përgjigje, si dhe aktualisht rezulton që KESH sh.a. ka bërë aplikimin për pajisjen me lejen e përdorimit të burimit ujqor nga AMBU-ja.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike në zbatim të aneksi A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në kushtet kur shoqëria KESH sh.a. ka depozituar në ERE “Miratimin në parim për pikën e lidhjes së dy njësive gjeneruese termike lundruese me rrjetin e transmetimit në zonën e Vlorës, Bashkia Vlorë” dhe është në proces të nënshkrimit të marrëveshjes së lidhjes me rrjetin me OST sh.a., për të sqaruar me shoqërinë mungesat e konstatuara, për sa i përket nënshkrimit të marrëveshjes së lidhjes me rrjetin me OST sh.a. dhe pajisjen me lejen e përdorimit të burimit ujqor nga AMBU-ja, vlerësohet të zgjatet me 30 ditë pune afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s.

- Lidhur me shtyrjen e vendimmarrjes, në nenin 53, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “3. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor”.

- Po ashtu, “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, në nenin 14 pika 3, të saj përcakton, se: “3. Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë pune”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 ditë punë afatin e vendimmarrjes, në lidhje me licencimin e shoqërisë “Korporata Elektroenergjetike shqiptare (KESH)” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-i i lundrueshëm i instaluar në Portin e Triportit në Gjirin e Vlorës.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti